

V E N D I M
Nr. 544, datë 14.11.1994

PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE PËR BIRËSIMET

(Ndryshuar me VKM nr. 527, datë 2.10.1995; nr. 285, datë 2.6.2000)

(i përditësuar)

Me propozimin e Komitetit Shqiptar të Birësimeve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpenzimet që bëhen për verifikimin dhe përgatitjen e dosjeve me dokumentet përkatëse të përcaktuara në ligj për çdo të mitur që birësohet, përballohen nga personat birësues shtetas shqiptarë a të huaj, sipas tarifave dhe taksave të caktuara me dispozitat në fuqi. Pagesa e shpenzimeve bëhet pasi merret vendimi për birësim nga gjykata.

2. Shpenzimet për shërbimet që kryhen nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve për birësimin e të miturve shqiptarë nga shtetasit e huaj, përballohen nga organizatat private a shtetërore të huaja të birësimeve me të cilat Komiteti bashkëpunon, në masën që përcaktohet në marrëveshjet dypalëshe ndërmjet Komitetit dhe këtyre organizatave.

3. Për birësimin e të miturve nga shtetas shqiptarë, shpenzimet për shërbimet që kryhen nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve, përballohen nga këta shtetas sipas tarifave të caktuara nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Birësimeve.

4. *Të ardhurat sipas pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi derdhen në bankë në llogarinë e Komitetit Shqiptar të Birësimeve, kurse të ardhurat sipas pikës 1 kalojnë për llogari të institucioneve që përgatitin dosjet.*

5. *Anëtarët e Komitetit Shqiptar të Birësimeve kur marrin pjesë në mbledhje marrin një shpërblim mbi pagë, deri në 5 000 (pesëmijë) lekë në muaj. Dhënia e shpërblimit vendoset nga Kryetari i Komitetit Shqiptar të Birësimeve në përputhje me veprimtarinë dhe kontributin e çdo anëtari.*

Fondet e shpërblimit, përjashtimisht vetëm për vitin 1994, përballohen nga buxheti i miratuar për aparatin e Këshillit të Ministrave.

6. Rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij vendimi caktohen nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi